



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pzd.nr.115/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit M. (O.) G., nga fshati LL., komuna e G., për shkak të veprës penale vjedhja grabitqare, nga neni 316 par.2 e 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173 par.1, nënpar.1.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të dënuarit, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 29.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të dënuarit M. G., për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për krime të rënda PKR.nr.394/2022 të datës 07.12.2022.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.394/2022 e datës 07.12.2022, të dënuarin M. G., për veprat penale vjedhja grabitqare nga neni 316 par.2 e 1 të KPRK-së, vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173 par.1, nënpar.1.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 29.06.2022 e tutje, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin, nr:2022:134095, e ka vërtetuar aktgjykimin e lartcekur.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur i dënuari M. G., me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, t'ia zbusë dënimin.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KZJD.nr.115/2024 e datës 09.10.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet si e pabazuar. Propozim të njëjtë ka dhënë edhe Gjykata Themelore në Prishtinë, me shkresën KP.nr.315/2024 e datës 13.09.2024, si dhe Prokurori i Themelores në Prishtinë, në mendimin PP.I.nr.528/2022 e datës 11.09.2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 431 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, propozimet e lartë cekura dhe gjeti se:

- kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit është e pabazuar.

Me dispozitën e nenit 429 të KPP-së, parashihet se zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet kur pas formës së prerë të aktgjykimit paraqiten rrethanat të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënimin më të ulët.

Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me këtë dispozitë vlerëson se rrethanat që theksohen në kërkesë a kanë peshë ligjore dhe a janë të asaj natyre që do të mund të ndikonin në një dënim më të butë, gjithnjë duke pasur parasysh peshën e veprës penale si dhe rrethanat e kryerjes së saj.

Në kërkesë e tij i dënuari thekson se, familja e tij ballafaqohet me gjendjen e rëndë ekonomike, është familjar ka gruan dhe tre fëmijë të vegjël e të cilët jetojnë me asistencë sociale dhe pa përkujdesjen e tij, ka sjellje të mira brenda institucionit korrektues, është i angazhuar në punë dhe avancuar në pavijon. Andaj propozon që t'i zbutet dënimi dhe ti jepet mundësia që ti kthehet familjes, të përkujdeset për ta, të jetë i dobishëm për familje dhe shoqëri dhe të kthehet si person i risocializuar.

Nga shkresat e lëndës del se gjykatat e instancave më të ulëta me rastin e vendosjes lidhur për llojin dhe lartësinë e dënimit kanë vlerësuar rrethanat të cilat kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit. Rrethanat në të cilat thirret i dënuari në kërkesë nuk janë të asaj natyre që e justifikojnë zbutjen e dënimit, ngase vuajtja e dënimit për pasojë ka mos mundësinë e përfilljes së disa obligimeve të cilat mund të kryhen kur personi është në liri dhe është pasojë e heqjes së lirisë.

Nga sa u tha, kjo gjykatë gjen se nuk janë plotësuar kushte ligjore për aprovimin e kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe konform dispozitës së nenit 431 par.7 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pzd.nr.115/2024, më datë 29.10.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi